

VENDIM
Nr.375, datë 31.5.2005

PËR RRITJEN E TRAJTIMEVE FINANCIARE, TË VEÇANTA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 1 të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të nenit 5 të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension”, të nenit 8 të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake” dhe të nenit 6/1 të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, me datë fillimi deri më 31.5.2005, përfshirë edhe këtë datë, të rriten në masën 8 për qind.

2. Masat e trajtimeve të veçanta, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension”, me datë fillimi deri më 31.5.2005, përfshirë edhe këtë datë, të rriten në masën 8 për qind.

3. Masat e trajtimeve të veçanta, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, me datë fillimi deri më 31.5.2005, përfshirë edhe këtë datë, të rriten në masën 8 për qind.

4. Masat e trajtimeve të veçanta, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, të ndryshuar, me datë fillimi deri më 31.5.2005, përfshirë edhe këtë datë, të rriten në masën 8 për qind.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2005, llogariten në shumën 27 500 000 (njëzet e shtatë milionë e pesëqind mijë) lekë dhe të përballohen nga buxheti i po këtij viti, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

6. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.6.2005.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano